



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data:18.07.2024

NRP: 04-353-zyrtar

**Raporti (me komente) për ecurinë e shqyrtimit dhe hartimit të
Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit 2024-2032**

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH/05-2014, neni 12, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit publikon Raportin e Shqyrtimit Publik të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

Plani Rregullues i Hollësishëm ka qenë në shqyrtim publik nga data 03.06.2024 deri më 12.07.2024

Gjatë kësaj periudhe vërejtje, propozime, sugjerime dhe kërkesa me shkrim në fletoren zyrtare i kanë adresuar gjithsej 9 qytetarë.

Autoriteti përgjegjës i Planifikimit Hapësinor në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me të gjithë sektorët e tjerë i është përgjigjur secilës kërkesë dhe përgjigjet do ti gjeni në formë tabelare më poshtë me të gjitha të dhënat.

Ne i falënderojmë të gjithë qytetarët, MMPH, shoqërinë civile, mediat, institucionet, bizneset për vërejtjet dhe ndihmën e tyre në hartimin e versionit final të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren për periudhën 2024-2032.

Autoriteti përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit) dhe përfaqësuesit e sektorëve (Drejtorive) të tjerë të Komunës.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **24.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf>

Në facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02iGibBgEMtt9Afs2k3A89MGWTHZywhiJ4qfs3RZKmkSbPxo2UKhcYKxEgxdM5j1Lol&id=100064489910139&mibextid=RtaFA8

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=30&ClosedPage=0>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf>

Me 24.05.2024, njoftimi dhe plani përmes emailit u është dërguar: Qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata, drejtor të shkollave fillore dhe të mesme, bizneseve, organizatave studentore, ekspertëve të fushave të ndryshme, mediat lokale, shoqata të ndryshme, organizata rinore si dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Me 03.06.2024, është mbajtur shqyrtimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e shqyrtimit publik:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-strategjine-komunale-dhe-planit-te-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2024-2027/>

Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

04.06.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e shqyrtimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz: _

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/11/Procesverbali-per-Projekt-Planin-Rregullues-te-Hollësishem-Parku-i-Biznesit-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në shqyrtim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **03.06.2024** deri me **12.07.2024**, gjatë kësaj periudhe janë pranuar komentet, sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale për dokumentin.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e shqyrtimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit	03.06.2024 Nga-10:15 Deri-12:00	F M T 20 15 35	9	0-Pjesërisht 5-Refuzohen 4-Pranuara 0-Adresuar

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës Pranuar: Refuzuar: Pranuar Pjesërisht: Adresuar:	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1	Kërkesë për ndarje të Parcelës Industriale në bazë të propozimit të Shoqatës si dhe madhësia e parcelave të jetë nga 30 ari deri në 1 hektar dhe shfrytëzueshmëri të tokës deri në 80% me mundësi zgjerimi	Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve të Prizrenit - SHZAP	Refuzohet	Parcelat ndahen në bazë të kushteve të caktuara me HZK të komunës së Prizrenit, sipas nevojave bizneset mund të aplikojnë në mënyrë të kombinuara (merr 2 – 3 apo më shumë parcela me marrëveshje).

2	Kërkesë për ndarje të parcelave në zonën e re industriale, Lubizhdë.Për zgjerimin e aktivitetit duke ndërtuar poligonet për të gjitha kategoritë e patent-shoferit.	Geni SH.P.K	Refuzohet	Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veçantë për ndarje të parcelave.
3	Kërkesë për ndarje Parcelle Industriale në Parkun e Biznesit (20-30 ari) për implementimin e projektit për prodhimin e mobilerisë dhe inventarizime dekorative të punuara me dru.	DUNNAGE BAG INTERNATIONAL SH.P.K.	Refuzohet	Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veçantë për ndarje të parcelave.
4	Kërkesë për Zonën Ekonomike,Lubizhdë /Kërkesë për përshpejtim të PRRH-së.	ProMetal SH.P.K	Pranohet	Si projekt është në procedurë të cilin edhe ne si komunë po mundohemi me e përshpejtu në mënyre që të jetë sa më parë i miratuar dhe të jetë në shërbim të bizneseve.
5	Kërkesë për ndarje Parcelle Industriale si dhe madhësia e parcelave të jetë nga 30 ari deri në 1 hektar dhe shfrytëzueshmëri deri në 80%.	Proton Cable L.L.C	Refuzohet	Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veçantë për ndarje të parcelave gjithashtu Parcelat ndahen në bazë të kushteve të caktuara me HZK të komunës së Prizrenit, sipas nevojave bizneset mund të aplikojnë në mënyrë të kombinuara (merr 2 – 3 apo më shumë parcela me marrëveshje).
6	Kërkesë për ndarje parcele në zonën industriale, Lubizhdë.	Fatmir Telaku B.I	Refuzohet	Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veçantë për ndarje të parcelave.
7	Kërkojmë që në zonën A13 të shtohet edhe prodhim dhe industri	Hysni Hoti	Pranohet	Gjatë shqyrtimit të kërkesës kemi parë që është e mundur të shtohet edhe ky destinim andaj edhe kemi vendosur që të bëhet si e tillë.
8	Kërkesë për respektim të marrëveshjes me ish kryetarin	Dukagjin Kabashi	Pranohet	Ngastra ne fjale mbeten ne vendin e vet apo sipas marrëveshjes me riparcializim vendoset ne zonen e hyrjes
9	Kërkesa për ndryshim të pronësisë.	Valdet Hoxha	Pranohet	Pas verifikimit të Pronësisë si dhe Certifikatës së pronësisë të dorëzuar si dëshmi kjo vendoset te ndryshohet ashtu siç është.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit,
2. Njoftimin për mbajtjen e shqyrtimit publik.

Raporti është përgatitur nga :
